



BASHKIA E TIRANËS

# NJOFTIM

Njoftohen të gjithë subjektet e interesuar se në zbatim të vendimit nr. 9 dt 17.02.2016 të KKT-së për "Zbatimin e Planeve të Përgjithshme Vendore nga autoritetet vendore të zhvillimit të territorit" (i ndryshuar), në mbështetje të ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 për "Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" (i ndryshuar) dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, ju informojmë se:

Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, ka nisur hartimin për fazën e parë të njësive strukturore : **2-23 dhe fazat e dyta të Planeve të Detajuara Vendore të njësive strukturore , 1/38 zona A5, 6/8 zona A2, 8/23 zona A1, 8/24 zona A5, 2-28 zona A4 & A5, 2/58 zona A1, 3/22 zona A1 & A2 dhe 4/8 zona A3, 6/18 ASHP1 të hartuara nga Bashkia e Tiranës.**

Këto PDV, pasi u shqyrtuan nga sektorët e Makroplanifikimit dhe Mikroplanifikimit (Drejtoria e Planifikimit të Territorit/ DPPZHT ), rezultuan në përputhje me parashikimet e Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë së Tiranës të miratuar me vendimin nr.1 të KKT-së dt 15.02.2013 dhe legjisllacionin përkatës, ndaj do të nisë procedura për shqyrtimin administrativ të tyre.